



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 16 shkurt 2022
Nr.ref.: RK1946/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI137/21

Parashtrues

Afrim Aziri

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 138/21, të 14 prillit 2021

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Afrim Aziri, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar me autorizim nga Ekrem Agushi, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 138/21, të 14 prillit 2021, në ndërlidhje me Aktgjykimin Ac. nr. 5426/17 të 4 nëntorit 2020 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) në lidhje me Aktgjykimin C. nr. 3428/13 të 20 korrikut 2017 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), si dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 (E drejta për Zgjidhje Efektive) të KEDNJ-së.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 28 korrik 2021, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
6. Më 3 gusht 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 13 gusht 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që të dorëzojë parashtrësata tjera që ai i ka dorëzuar në gjykatat e rregullta dhe parashtrësata nga pala tjetër. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi edhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 24 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë padinë, përgjigjen në padi, ankesën, revizionin, përgjigjen në revizion e të paditurës dhe ankesën e kësaj të fundit.
9. Më 2 shkurt 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Sipas shkresave të lëndës, rezulton që parashtruesi i kërkesës, më 31 janar 2007, është emëruar në pozitën e Drejtorit Menaxhues në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (në tekstin e mëtejme: ANP).
11. Më 25 mars 2008, me Aktvendimin për paraburgim PPH. nr. 106/08 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, ndaj parashtruesit të kërkesës është caktuar masa e paraburgimit, në të cilin parashtruesi qëndroi deri më 25 prill 2008. Më pas, ky Aktvendim për paraburgim është zëvendësuar me masën e ndalimit për t'iu ofruar vendit dhe personit të caktuar, si dhe me masën e paraqitjes në Stacionin Policor në Prishtinë në periudhën prej 24 prillit 2008 deri më 24 maj 2008.
12. Më 3 shtator 2008, ANP-ja e shkarkoi parashtruesin e kërkesës nga detyra me pretendimin për keqmenaxhim.
13. Më 23 janar 2009, ndaj parashtruesit të kërkesës është ngritur aktakuza nga Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë, dhe Aktgjykimin e parë lirues e nxori fillimisht gjykata e shkallës së parë, duke pasuar më tej edhe gjykata e shkallës së dytë, dhe duke u vërtetuar nga Gjykata Supreme, më 3 prill 2012.
14. Sipas shkresave të lëndës, parashtruesi i kërkesës për shkak të procedurës penale të iniciuar kundër tij kishte përjetuar dhimbje shpirtërore, për çka ky fakt është vërtetuar përmes ekspertizës.
15. Më 18 mars 2013, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, përmes komisionit përkatës i ofroi parashtruesit të kërkesës (barazim-jashtëgjyqësor) përkatësisht kompensimin në vlerë prej 410 euro, për shkak të privimit të paligjshëm të lirisë në kohëzgjatje prej 30 ditëve.

Procedura e iniciimit të kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit

(a) Procedura në Gjykatën Themelore

16. Më 17 dhjetor 2013, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi për shpërblim dëmi në Gjykatën Themelore kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KGJK) si i paditur i parë dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK) si i paditur i dytë, duke theksuar se meqenëse kanë ndodhur veprime joligjore lidhur me çështjen e tij, përkatësisht procesin penal nga ana e gjykatave dhe autoriteteve publike, ai kërkoi që (i) në emër të dëmit jomaterial-për dhimbje shpirtërore për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, shumën prej 800,000.00 euro; ndërsa (ii) në emër të dëmit material, kërkoi pagesën për shpenzimet e procedurës penale dhe për shkak të mosrealizimit të të ardhurave personale.
17. Më 14 nëntor 2016, KGJK parashtrroi përgjigje në padi, ku theksoi se parashtruesi i kërkesës konform nenit 526, paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPRK) ka paraqitur kërkesë për kompensim të dëmit material dhe jomaterial pranë KGJK-së.

Komisioni përkatës i KGJK-së më 18 mars 2013, i ka ofruar parashtruesit të kërkesës kompensimin në vlerë prej 410 euro, për shkak të privimit të paligjshëm të lirisë në kohëzgjatje prej 30 ditëve. KGJK theksoi se Udhëzimi Administrativ i KGJK-së 04/2015 për Zbatimin e Procedurës për Kompensimin e Dëmit për Personat e Dënuar ose Arrestuar Pa Arsye, nuk parasheh kompensimin e dëmit për shkak të zhvillimit të procedurës penale. KGJK e kundërshton legjitimitetin pasiv të tyre në këtë rast sepse konsideron se sa i përket kallëzimit penal, aktakuzës së ngritur dhe veprimeve tjera të gjykatës ai nuk ka legjitimitet real. Në anën tjetër, edhe KPK-ja po ashtu dorëzoi përgjigje në padi, si i paditur i dytë, duke e konsideruar kontestuese bazën juridike për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv real.

18. Më 20 korrik 2017, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit C. nr. 3428/13, (i) aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) detyroi të paditurit, Këshillin Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KGJK) dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK), që solidarisht për shkak të dëmit jomaterial, për dhimbje shpirtërore të shkaktuara për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit t'ia paguajnë parashtruesit të kërkesës shumën prej **61,708.30€** dhe për dëmin material për angazhim të avokatit në procedurë penale shumën prej 8,000.00€, kamatën sipas mjeteve të deponuara në banka pa destinim të caktuar mbi një vit nga dita e vendosjes, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,947.00€; ndërsa (iii) refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadisë mbi shumën e gjykuar sipas pikës (i) për dëmin jomaterial 61,708.30€ e deri në shumën e kërkuar prej 800,000.00 €, për kërkesën në lidhje me kamatën e kërkuar në shkallën 8%, dhe për shpenzimet e procedurës mbi shumën 1,947.00 € e deri në shumën e kërkuar prej 2,837.00€.
19. Gjykata Themelore arsyetoi se në mes të parashtruesit të kërkesës dhe KGJK-së nuk është kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, por si kontestuese është lartësia për dëmin jomaterial - material mbi shumën prej 410.00€ dhe për dëmin material në shumë prej 8,000.00€, ndërsa për KPK-në kontestuese është baza juridike për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv. Gjykata Themelore në këtë linjë, theksoi se sipas Udhëzimit Administrativ (04/2015) të KGJK-së për Zbatimin e Procedurës për Kompensimin e Dëmit për Personat e Dënuar ose të Arrestuar pa Arsye, sipas nenit 10, paragrafi 1, për dëmin material – fitimin e humbur është caktuar shuma prej 9.00€ për një ditë, ndërsa për vizitën familjare apo për pakon familjare është caktuar shuma prej 25€ për çdo vizitë, maksimalja 50.00€, ndërsa për dëmin material, sipas nenit 12, paragrafi 1, për dhimbjet shpirtërore, psikike dhe frikë është caktuar shuma ditore prej 6.00€.
20. Gjykata Themelore për llogaritjen e shumës arsyetoi si në vijim: (i) bazuar në ekspertizën mjekësore, vendosi që parashtruesit të kërkesës për vuajtjet shpirtërore gjatë periudhës së paraburgimit për 30 (tridhjetë) ditësh t'ia caktojë shpërblimin në shumë prej 3,600.00€ duke marrë parasysh se ai është figurë publike si Drejtor i një Ndërmarrje, duke ia llogaritur për çdo ditë të qëndrimit në paraburgim nga 120.00€; (ii) meqenëse parashtruesi i kërkesës pas 30 (tridhjetë) ditëve është liruar nga paraburgimi, atij i është kufizuar aktiviteti për t'i takuar personat e caktuar dhe objektet, dhe për faktin që ka qenë i obliguar të paraqitet në Stacionin Policor për 30 (tridhjetë) ditë dhe i është konfiskuar

dokumenti i udhëtimit të njëjtit për 30 ditë, i është caktuar shpërblimi në shumë prej 1,800.00€, ose për çdo ditë nga 60.00€; (iii) për periudhën e muajit qershor – dhjetor të vitit 2008, në të cilën periudhë paditësi ka qenë duke vuajtur shpirtërisht dhe nën ndikimin e kufizimeve në aktivitetet e tij, Gjykata Themelore ia ka caktuar shpërblimin në shumë prej 7,800.00 € ose për çdo muaj nga 1,300.00 €; (iv) për faktin që gjatë vitit 2009 ndaj paditësit është ushtruar aktakuza për pesë pika të saj; (v) për periudhën e vitit 2009 dhe vitit 2010, si pasojë e vuajtjeve shpirtërore gjykata ia gjykoj paditësit shumën për çdo vit veç e veç nga 15,600.00 €, duke llogaritur për çdo muaj nga 1,300.00€ ose për çdo ditë nga 43.33€; (vi) për vitin 2011, deri në ditën e shpalljes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë më 7 korrik 2011, ka gjykuar shumën prej 8,103.30 €, duke marrë për bazë për çdo ditë shumën nga 43.33 €; (vii) meqenëse parashtruesi i kërkesës është liruar nga përgjegjësia penale e deri në vërtetimin e aktgjykimit nga Gjykata Supreme më 3 prill 2012, ka gjykuar shumën ditore nga 35,00€ (ose vetëm për muajin korrik është llogaritur shuma prej 735.00€), ndërsa për periudhën e muajit gusht 2011 deri më 3 prill të vitit 2012 për çdo muaj është llogaritur nga 1,050.00€ ose për periudhën prej 8 korrikut 2011 deri më 3 prill 2012, shuma e tërësishme prej 9,205.00 €. Të gjitha këto, në aspektin matematikor në shumë prej **61.708,30 €**. Në anën tjetër, Gjykata Themelore refuzoi kërkesën e paditësit mbi shumën e gjykuar për dhimbje shpirtërore të shkaktuara për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit prej 61,708.30€ e deri në shumën e kërkuar prej 800,000.00€ si shumë e lartë dhe joreale, pastaj edhe si tejkalim i qëllimit të shpërblimit.

21. Në lidhje me dëmin jomaterial, Gjykata Themelore zbatoi dispozitën e nenit 200 të LMD-së, duke theksuar se shuma prej 61,708.30 euro është e drejtë dhe parashtruesi i kërkesës me këtë shumë mund t'i plotësojë të mirat e dëmtuara si pasojë e vuajtjeve dhe përjetimeve shpirtërore që ka përjetuar. Gjykata në lidhje me kamatën ka zbatuar nenin 277, paragrafi 1 të LMD-së, kjo për shkak se kërkesa kryesore kur është shkaktuar ngjarja – raporti juridiko-civil – është e lidhur me kërkesën aksesore-kamatën, ashtu që dëmi është shkaktuar në kohën kur ka qenë në fuqi ligji i vitit 1978, ndërsa refuzoi kërkesën për kamatë në shkallën prej 8% sipas ligjit të ri.
22. Sa i përket pikës (ii) të dispozitivit, ku Gjykata Themelore refuzoi kërkesën e parashtruesit mbi shumën e gjykuar për dhimbje shpirtërore të shkaktuara për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit prej 61,708.30€ e deri në shumën e kërkuar prej 800,000.00€, si shumë e lartë dhe joreale, pastaj edhe si tejkalim i qëllimit të shpërblimit. Gjykata Themelore më tej vlerësoi se pa marrë parasysh faktin se parashtruesi i kërkesës ka nevojë për tretman mjekësor, meqenëse i njëjti është kthyer në vendin e tij të punës, me kthimin në vendin e punës si i pafajshëm të njëjtit i është kthyer edhe besimi në shoqërinë dhe rrethin ku jeton dhe punon, kështu që ky veprim manifestohet si veprim të rehabilitimit nga ana e shoqërisë për parashtruesin e kërkesës.
23. Gjykata Themelore, në fund, vlerësoi se Udhëzimi Administrativ nr. 04/2015, vlen vetëm për rastet kur palët arrijnë marrëveshje jashtëgjyqësore, ndërsa ky udhëzim është pa ndikim, nuk është obligativ për gjykatën në lidhje me gjykimin e kërkesave të personave të dëmtuar, për të cilat konsideroi se ka dhënë arsyet

si më lart dhe se ka analizuar çdo rrethanë veçanërisht kur është përcaktuar në lidhje me gjykimin e demit jomaterial.

(b) Procedura në Gjykatën e Apelit

24. Në një datë të pacaktuar, KGJK parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Sipas vlerësimit të KGJK-së, gjykata e shkallës së parë shpërblimin e demit jomaterial ndaj parashtruesit të kërkesës nuk e ka bërë në pajtim me shkallën e dhimbjeve shpirtërore dhe kohëzgjatjen e tyre si dhe me pasojat e shkaktuara. Andaj, KGJK argumentoi se gjykata gabimisht ka aplikuar nenin 200 të LMD-së lidhur me pjesën e gjykuar sepse shpërblimi i demit jomaterial nuk është në proporcion me pasojat e shkaktuara shëndetësore të parashtruesit dhe ky shpërblim nuk është në pajtim me qëllimin e shpërblimit të demit jomaterial. Në anën tjetër, KPK po ashtu parashtrroi ankesë, duke përsëritur, në esencë, argumentin se të njëjtit i mungon legjitimiteti i plotë real pasiv për të qenë palë në kontest, dhe se nuk ekziston raporti juridiko-civil mes parashtruesit të kërkesës dhe KPK-së.
25. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që pjesa (i) e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të ndryshohet.
26. Më 4 nëntor 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit Ac. nr. 5426/17, (i) aprovoi si pjesërisht të bazuar ankesën e KGJK-së, dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, C. nr. 3428/13, në pjesën e parë të dispozitivit lidhur me kërkesëpadinë për shkak të demit jomaterial, për dhimbje shpirtërore të shkaktuara për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit; dhe (ii) detyroi KGJK-në që parashtruesit të kërkesës në emër të kompensimit për dhimbje shpirtërore të shkaktuara për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, t'ia paguajë shumën prej 45,000€, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë për dhimbje shpirtërore të shkaktuara për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit përtej shumës së gjykuar, refuzohet si e pabazuar; (iii) miratoi si pjesërisht të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës në pjesën e dispozitivit lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, ashtu që (iv) detyrohet KGJK Prishtinë, që paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguajë shumën prej 2,688.80€, ndërsa pjesa e kërkesës për shpenzime të procedurës përtej shumës së aprovuar, refuzohet e pabazuar; (v) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë në pjesën e kamatës së gjykuar e vërtetoi; (vi) aprovoi tërësisht ankesën e KPK-së, dhe ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore ashtu që refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, që KPK t'ia paguajë me solidarësi atij për kompensim dëmi për dhimbje shpirtërore të shkaktuara për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, dëmin material, kamatën dhe shpenzimet e procedurës në mungesë të legjitimitetit pasiv të palës.

27. Gjykata e Apelit fillimisht theksoi se duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë në kuptim të dispozitës së nenit 195, paragrafi 1, pika (e) lidhur me nenin 201, paragrafi 1, pika (d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK), sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht për KGJK-në, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale. Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit vlerësoi se shumica e aprovuar nga gjykata e shkallës së parë në emër të dëmit jomaterial për dhimbjet e përjetuara shpirtërore si pasojë e cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit të parashtruesit të kërkesës, nuk bazohet në kriteret e zbatueshme për vlerësim, as në praktikën gjyqësore të krijuar nga gjykatat e Kosovës për këto forma të shpërblimit të dëmit dhe as në natyrën dhe llojin e të mirës së dëmtuar. Në këtë linjë, Gjykata e Apelit vlerësoi se shumica e gjykuar si në pikën e parë të dispozitivit të Aktgjykimit të saj është adekuate me kriteret dhe qëllimet e përcaktuara me nenin 200 të LMD-së lidhur me nenin 323 të LPK-së, se kjo shumë përfaqëson një satisfaksion adekuat që i dëmtuari t'i përballojë më lehtë dëmet jomateriale të pësuar. Gjykata e Apelit, lidhur me vlerën e kompensimit mori parasysh rrethanat që kanë ndikuar në atë shkallë të të drejtave të cenuara si pasojë e procedurës penale, siç janë: (i) kohëzgjatja e qëndrimit në paraburgim; (ii) natyra e veprës për të cilën është akuzuar; (iii) mosha e të dëmtuarit dhe profesioni i tij; si dhe (iv) rrethanat familjare e shoqërore.
28. Më tej, Gjykata e Apelit pranoi pretendimin ankimor të parashtruesit të kërkesës duke e detyruar KGJK-në që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 2.688.80€, konform dispozitave të LPK-së, dhe tarifave përkatëse të OAK-së që kanë qenë në fuqi. Gjithashtu, edhe për kamatën e konsideroi të njëjtën në pajtim me dispozitat e nenit 277 të LMD-së, duke e llogaritur atë sipas mjeteve të deponuara në banka pa destinim të caktuar mbi një vit prej ditës së marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë e deri në pagesën definitive.

(c) Procedura në Gjykatën Supreme

29. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Sa i përket shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, parashtruesi i kërkesës argumentoi se gjykatat nuk janë bazuar në arsye të plota dhe të kuptueshme për faktet vendimtare, ndërsa për pretendimin për shkelje të dispozitave të së drejtës materiale parashtruesi i kërkesës theksoi se i referohet lartësisë së kompensimit për dhimbjet e përjetuara shpirtërore, dhe vlerat personale të tij janë të mbrojtura me dispozitat e nenit 26, paragrafi 1 të Kushtetutës dhe në nenin 5, paragrafi 1 të KEDNJ-së. Ndërsa në fund, konsideroi se është zbatuar gabimisht neni 200 i LMD-së sepse shumica e gjykuar është refuzuar si e pabazuar.
30. Më 15 dhjetor 2020, KGJK po ashtu parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme. Përmes revizionit, KGJK pretendoi konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Sa i përket aplikueshmërisë së nenit 200, paragrafi 1 të LMD-së, deklaroi se të njëjtin nuk e kundërshton, por e

kundërshton lartësinë e kompensimit në emër të vuajtjeve shpirtërore dhe shkeljes së dinjitetit dhe lirisë, dhe iu referua kriterëve të parapara me Udhëzimin Administrativ 04/2015 për Zbatimin e Procedurës për Kompensimin e Dëmit për Personat e Dënuar ose të Arrestuar Pa Arsyë, dhe pretendon se nuk është zbatuar praktika gjyqësore që ka vendosur për dëmin jomaterial. Jashtë kriterëve të udhëzimit përkatës, KGJK e konsideron si të pabazuar kompensimin. KGJK konsideroi se gjykatat do duhej të kishin parasysh gjendjen ekonomike në Kosovë dhe mundësitë buxhetore të KGJK-së dhe konsiderojnë se shumica e akorduar nga gjykata e Apelit në vlerë prej 45,000 euro është jashtëzakonisht e lartë dhe pa precedent për vetëm 30 ditë privim lirie në paraburgim. KGJK theksoi se nga praktika gjyqësore të dëmtuarve në këto raste u akordohet 50 deri në 70 euro dëmshpërblim për ditë. Lidhur me këto pretendime, në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës gjithashtu parashtrroi përgjigje në revizion.

31. Më 14 prill 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit Rev. nr. 138/2021, (i) pranoi pjesërisht si të bazuar revizionin e KGJK-së dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në pikën I të dispozitivit dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në pjesën e dispozitivit lidhur me kompensimin për dëmin jomaterial, për dhimbje shpirtërore të shkaktuara për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit; dhe vendosi të (iii) detyrohet KGJK, që parashtruesit të kërkesës në emër të kompensimit të dëmit jomaterial për dhimbje shpirtërore të shkaktuara për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, t'ia paguajë shumën prej **3,600.00€** (tre mijë e gjashtëqind euro), ndërsa pjesën tjetër e kërkesëpadisë për këtë formë të dëmit, përtej shumës së gjykuar, e refuzoi si të pabazuar.
32. Fillimisht, Gjykata Supreme deklaroi se baza juridike sa i përket detyrimit të paditurit KGJK-së që paditësit t'ia paguajë dëmin, për shkak të privimit të lirisë dhe qëndrimit në paraburgim në mënyrë të paligjshme, nuk ka qenë kontestuese, prandaj Gjykata Supreme në këtë pjesë sa i përket zbatimit të dispozitave materialo-juridike është kufizuar, duke qenë se deklarimi për bazën është çështje që i referohet disponibilitetit të kërkesave për të cilën palët mund të disponojnë lirisht në këtë rast. Gjykata Supreme lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimeve të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, sa i përket dëmit jomaterial, që parashtruesit të kërkesës në emër të dhimbjeve shpirtërore të shkaktuara për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare dhe sipas pretendimeve në revizion për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimeve në kuptim të dispozitës së nenit 224, paragrafi 1 të LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar e drejta materiale.
33. Sipas Gjykatës Supreme, gjendja faktike për dëmin jomaterial për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, sepse gjykata e shkallës së parë me ekspertizë mjekësore të punuar nga eksperti i psikiatrisë, ka gjetur se paditësi si

pasojë e arrestimit dhe qëndrimit në paraburgim dhe kohëzgjatjes së procesit në procedurën penale të zhvilluar ndaj tij, deri në shpalljen e aktgjykimit dhe deklarimit si të pafajshëm, ka pësuar dhimbje shpirtërore. I njëjti ka qenë nën stresin e vazhdueshëm për shkak të ecurisë së procesit gjyqësor kundër tij duke qenë i pasigurt për të ardhmen e tij.

34. Në rastin konkret, në kontekstin e dispozitës nga paragrafi 1 i nenit 200 të LMD-së, Gjykata Supreme konsideroi se parashtruesit të kërkesës i takon kompensimi për dhimbje shpirtërore për shkak të shkeljes së nderit ose të lirisë, dhe formulimi si në kërkesëpadi nga pala paditëse për këtë formë të dëmit në vete paraqet kërkesën për të dy këto kategori të cilat i ka njohur ligji si bazë për shpërblim të dëmit jomaterial, ndonëse janë paraqitur si një kërkesë e vetme monetare, andaj Gjykata Supreme mori parasysh këtë rrethanë me rastin e caktimit të lartësisë së dëmit jomaterial, duke vlerësuar se parashtruesit të kërkesës i është cenuar e drejta e lirisë, dhe po ashtu për shkak të zhvillimit të procedurës penale e cila ka përfunduar me aktgjykim lirues, të cilit i është cenuar edhe nderi, në kuptim të kësaj dispozite. Ndërsa sa i përket formulimit si në kërkesëpadi *“të dhimbjeve shpirtërore të shkaktuara për shkak të cenimit të autoritetit, dhe të drejtave të personalitetit”*, Gjykata Supreme konsideroi se *“ligji nuk i njeh si kategori të veçanta të shpërblimit të dëmit, por të njëjtat hynë në kuadër të dy kategorive të lartcekura për të cilat ligji njeh të drejtën e shpërblimit të dëmit jomaterial për dhimbje shpirtërore për shkak të shkeljes së nderit ose të lirisë, ndërsa duke marrë parasysh se nuk ka pasur kërkesë të veçantë monetare për këto kërkesa, gjykata i ka vlerësuar si joekzistente si të pavarura dhe të njëjtat i ka vlerësuar se hynë në kuadër të dy kërkesave për të cilat paditësit i është njohur e drejta për shpërblimin e dëmit jomaterial për dhimbje shpirtërore për shkak të shkeljes së nderit ose lirisë”*. Kjo sepse, kërkesa për dhimbje shpirtërore nuk mund të qëndrojë si e veçantë pa u ndërlidhë me ndonjërin nga rrethanat që e shkaktojnë dhimbjen shpirtërore.
35. Gjykata Supreme, duke pasur parasysh natyrën e përjetimeve, të dhimbjeve në aspektin psikik të shkaktuara parashtruesit të kërkesës, vlerësoi posaçërisht se rrethanat dhe natyra e veprës penale për të cilën ishte akuzuar paditësi ishte e rëndë, shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit, dhe rrjedhimisht dhimbjet shpirtërore për shkak të akuzës kanë qenë të mëdha, ashtu siç edhe eksperti ka konstatuar me ekspertizë, po ashtu duke marrë parasysh kohëzgjatjen e qëndrimit në paraburgim prej 30 ditësh, pozitën të cilën e ka pasur në shoqëri para arrestimit, jehonën mediatike që ka pasur arrestimi i tij, si dhe praktikën e mirë gjyqësore të krijuar për këtë formë të dëmit jomaterial, vendosi që kompensimi të jetë në lartësi prej 3,600.00 euro, duke vlerësuar se me këtë shumë paditësi do të ketë një satisfaksion për përjetimet e marra si rezultat i privimit të lirisë dhe procedurave të zhvilluara.
36. Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë për këtë formë të dëmit jomaterial për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, Gjykata Supreme vlerëson se shumica e gjykuar nuk është në harmoni me pasojat e krijuara dhe me qëllimin të cilit i shërben kompensimi dhe Gjykata Supreme me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit të dëmit jomaterial për shkak të cenimit të nderit dhe lirisë, duke vendosur të aprovohet dhe refuzohet kërkesa si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, theksoi se ka pasur parasysh edhe

praktikën e krijuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), lidhur me shkeljet nga neni 5 i Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, që kanë të bëjnë shkeljet e dispozitave të këtij neni ka caktuar shuma të përafërta me ato të gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Sipas Gjykatës Supreme, GJEDNJ me rastin e vendosjes lidhur me këto raste lidhur me nenin 5 të Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, ka pasur parasysh shkeljen e të drejtave të përcaktuara me këtë nen, që është e drejta për liri dhe siguri, volumin e të drejtave të cenuara dhe dhimbjeve shpirtërore të cilat janë shkaktuar si pasojë e këtyre shkeljeve subjekteve të caktuara, dhe se shumtë e gjykuara në këto raste nuk janë shumtë të mëdha, pasi qëllimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka qenë satisfaksioni i të dëmtuarve me rastin e gjyqimit të shumave për dëmin jomaterial, dhe në asnjë mënyrë pasurimi i tyre. Në këtë linjë, Gjykata Supreme, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, dhe faktin se ka të bëjë me vendim lirues, me të cilin parashtruesi i kërkesës është liruar nga përgjegjësia penale për veprën penale shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit për të cilën ishte akuzuar, me çka drejtësia është vënë në vend dhe se parashtruesi i kërkesës asnjëherë nuk është shpallur fajtorë për veprën për të cilën është akuzuar, e që gjithashtu duke marrë parasysh faktin se ai ka qëndruar në paraburgim 30 ditë, kohë kur paditësit i është cenuar e drejta e lirisë në kundërshtim me nenin 5 të Konventës, dhe ndaj tij procedura penale ka zgjatur nga 25 marsi 2008, kur është arrestuar, deri në përfundimin e kësaj procedure me aktgjykim të formës së prerë më 3 prill 2012, pasi që është një periudhë relativisht e gjatë, gjatë së cilës periudhë ka qenë i cenuar nderi i paditësit, dhe për këto arsye është e natyrshme që ka përjetuar dhimbje shpirtërore, të cilat fakte janë marrë parasysh me rastin e gjyqimit të shumës prej 3,600.00 euro, që është shumë më e lartë se shumtë e gjykuara edhe sipas praktikës së krijuar nga GJEDNJ-ja, rrjedhimisht sa i përket lartësisë së kompensimit të dëmit është i pathemeltë.

Ankesa e parashtruesit të kërkesës e dorëzuar tek Avokati i Popullit

37. Sipas shkresave të lëndës, parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar edhe një ankesë tek Institucioni i Avokatit të Popullit, përmes së cilës ai është ankuar lidhur me faktin që shumtë e gjykuar për dhimbje shpirtërore ka qenë pasojë e gjyqimit jo të rregullt, sepse ka konsideruar që KGJK si palë e paditur e mbikëqyr sistemin gjyqësor dhe bën emërimin e të gjitha niveleve të gjykatave të rregullta, andaj *“dhe ky raport ekzistues ndërmjet gjykatave si dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, e ka vu palën paditëse në pozitë të pabarabartë dhe për rrjedhojë ka rezultuar gjyqimi jo i drejtë nga të gjitha gjykatat instanciale”*. Andaj, parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit që të japë mendim apo opinion lidhur me këtë çështje.

Prendimet e parashtruesit të kërkesës

38. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjyqimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 (E drejta për Zgjidhje Efektive) të KEDNJ-së.

39. Parashtruesi i kërkesës, fillimisht, në elaborimin e shkeljeve të të drejtave të tij kushtetuese, vë theks në faktin që gjatë periudhës kohore kur ka qenë në paraburgim, përkatësisht gjatë periudhës prej 25 marsit 2008 deri më 25 prill 2008 e deri në ditën kur ai është liruar si i pafajshëm me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, AP-GZ. nr. 467/11 të 3 prillit 2012. Parashtruesi i kërkesës thekson se gjatë kësaj periudhe ai ka përjetuar dhimbje shpirtërore në kohëzgjatje prej 4 (katër) vitesh.
40. Përkitazi me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës thekson se KGJK gjatë tërë procedurës nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës, por e ka kontestuar vetëm lartësinë e shpërblimit të dëmit jomaterial për shkak të dhimbjeve shpirtërore për të gjitha format e dëmit të shkaktuar dhe atë cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit.
41. Në mbështetje të pretendimit të tij, parashtruesi i kërkesës thekson se gjykatat e rregullta kanë shkëlur dispozitat e Kushtetutës dhe KEDNJ-së, si dhe nenin 200, paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, i cili ka qenë i vlefshëm në kohën e shkaktimit të dëmit, dhe për këtë parashtruesi konsideron se shpërblimi i gjykuar për dëmin jomaterial për shkak të dhimbjeve shpirtërore për cenimin e autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtat e personalitetit në shumën prej 3,600.00 € është rrjedhojë e gjykimit jo të drejtë, sepse sipas parashtruesit të kërkesës KGJK si palë e paditur e mbikëqyr sistemin gjyqësor dhe bën emërimin e të gjitha niveleve të gjykatave të rregullta, andaj *“dhe ky raport ekzistues ndërmjet gjykatave si dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, e ka vënë palën paditëse në pozitë të pabarabartë dhe për rrjedhojë ka rezultuar gjykimi jo i drejtë nga të gjitha gjykatat instanciale”*.
42. Në vijim të kësaj, parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se kërkon nga Gjykata të konstatojë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk i ka arsyetuar bindshëm dhe në mënyrë faktike aktgjykimet e dy instancave më të ulëta, përkatësisht ato të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit.
43. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata të: (i) deklarojë kërkesën e tij si të pranueshme; (ii) të konstatojë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenit 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 138/2021, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 5426/2017, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, C. nr. 3428/13, dhe të urdhërojë këtë të fundit të rigjykojë lidhur me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

Neni 54

[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

NENI 6

E drejta për një proces të rregullt

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]

NENI 13

E drejta për zgjidhje efektive

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

KODI 04/L-123 I PROCEDURËS PENALE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 526

Kërkesa për kompensim nga organi administrativ dhe parashkrimi i saj

1. E drejta për kompensim dëmi parashkruhet tri (3) vjet pas formës së prerë të aktgjykimit të shkallës së parë me të cilin i akuzuari është liruar nga akuza ose me të cilin është refuzuar akuza, apo nga forma e prerë e aktvendimit me të cilin hedhet aktakuza ose pushohet procedura. Kur për

ankesë vendos gjykata më e lartë, e drejta për kompensim parashkruhet pas tri (3) vitesh nga dita e marrjes së vendimit nga gjykata e tillë.

2. Para se të paraqesë padinë në gjykatë për kompensim dëmi, i dëmtuari kërkesën e tij ia drejton organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore për arritjen e marrëveshjes për ekzistimin e dëmit, llojin dhe lartësinë e kompensimit.

3. Në rastin nga paragrafi 1. nënparagrafi 1.2. neni 525 i këtij Kodi, kërkesa mund të vendoset vetëm kur paditësi i autorizuar nuk e ka ndërmarrë ndjekjen në gjykatën kompetente brenda tre (3) muajve nga dita e marrjes së aktvendimit të formës së prerë. Nëse pas kalimit të këtij afati paditësi i autorizuar ndërmerr ndjekjen në gjykatën kompetente, procedura për kompensim dëmi pezullohet derisa të përfundojë procedura penale.

Neni 527 Padia për kompensim

1. Kur kërkesa për kompensim dëmi nuk miratohet ose organi publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore dhe i dëmtuari nuk arrijnë marrëveshje brenda tre (3) muajsh nga dita e paraqitjes së kërkesës, i dëmtuari mund të paraqesë padinë për kompensim dëmi në gjykatën kompetente. Nëse arrihet marrëveshje vetëm për një pjesë të kërkesës, i dëmtuari mund të paraqesë padi për pjesën tjetër të kërkesës.

2. Derisa zgjatë procedura nga paragrafi 1. këtij neni nuk ec afati i parashkrimit nga neni 526, paragrafi 1. i këtij Kodi.

3. Padia për kompensim dëmi paraqitet kundër organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore.

[...]

Neni 529 Personat që kanë të drejtë në kompensim për heqje lirie pa bazë

1. E drejta në kompensim dëmi i takon gjithashtu:
 - 1.1. personit i cili është mbajtur në paraburgim e kundër tij nuk është filluar procedurë penale ose procedura është pushuar me aktvendim të formës së prerë ose ai me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza apo akuza është refuzuar;
 - 1.2. personit i cili ka mbajtur dënimin me heqje të lirisë dhe me rastin e rishikimit të procedurës penale ose kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë i është shqiptuar dënim me burgim më të shkurtër nga dënimi të cilin e ka mbajtur, apo i është shqiptuar sanksion penal pa heqje të lirisë ose është deklaruar fajtor dhe është liruar nga dënimi;
 - 1.3. personit i cili për shkak të gabimit ose veprimit të paligjshëm të një organi është arrestuar pa arsye ose është mbajtur një kohë në paraburgim apo në një institucion korrektues për mbajtjen e dënimit ose masës së shqiptuar; dhe

1.4. personit i cili në paraburgim ka kaluar kohë më të gjatë se sa dënimi me burgim për të cilin është gjykuar.

2. Personi i cili sipas nenit 163 të këtij Kodi është arrestuar pa bazë ligjore, i takon e drejta në kompensim dëmi në qoftë se kundër tij nuk është caktuar paraburgimi ose nëse koha e arrestit nuk i është llogaritur në dënimin e shqiptuar për veprë penale ose kundërvajtje.

3. Kompensim dëmi nuk i takon personit i cili me veprimet e tij të palejueshme ka shkaktuar arrestimin. Në rastet nga paragrafi 1. nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2. të këtij neni përjashtohet e drejta në kompensim dëmi kur ekzistojnë rrethanat nga neni 525, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.1. dhe 1.2. të këtij Kodi.

4. Në procedurën për kompensimin e dëmit në rastet e parapara në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, dispozitat e këtij kapitulli zbatohen përshtatshmërisht.

LIGJI NR. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 323

Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t'i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë.

LIGJI PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE (i vitit 1978)

Kompensimi në të holla

Neni 200

Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi i dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material.

Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkelje së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.

UDHËZIM ADMINISTRATIV (04/2015) PËR ZBATIMIN E PROCEDURËS PËR KOMPENSIMIN E DËMIT PËR PERSONAT E DËNUAR OSE TË ARRESTUAR PA ARSYE

Neni 10

Kompensimi për dëmin material/fitimin e humbur

10.1 Për dëmin material/ fitimin e humbur për personat të dënuar ose të arrestuar pa arsye ligjore, nëse personat janë të papunësuar, shuma e përcaktuar e kompensimit që paguhet është nëntë (9) euro në ditë.

10.2 Shuma e njëjtë nga paragrafi 10.1 u pranohet edhe personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye nga baza e arrestit shtëpiak.

10.3 Nëse personi përmes kontratës origjinale të punës, dëshmon lartësinë e pagës, i njëjti kompensohet deri në lartësinë bruto të pagës.

10.4 Kompensimi gjithashtu përfshinë shpenzimet e mbrojtjes sipas tarifës së Odës së Avokatëve, duke i dëshmuar përmes procesverbaleve të seancave të zhvilluara dhe faturave të paguara përmes xhirollogarisë.

10.5. Personat (shtetasit kosovarë) me punë të përkohshme jashtë vendit, si dhe shtetasit e huaj të dënuar ose të arrestuar pa arsye janë të obliguar që gjithë dokumentacionin ta parashtrojnë të vërtetuar në shërbimin e noterisë.

Neni 11

Kompensimi për pako dhe vizita familjare

Në emër të kompensimit për shpenzimet e anëtarëve të familjes për vizitat e bëra personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye, dërgimit të pakove dhe të transportit për anëtarët e familjes, kompensohen me shumën prej njëzet e pesë (25) eurosh për një vizitë, përkatësisht shumën prej pesëdhjetë (50) eurosh, për dy (2) vizita mujore.

Neni 12

Kompensimi për dëmin jomaterial/moral

12.1 Për dëmin jomaterial/moral në emër të dhimbjeve të përjetuara psikike/shpirtërore, frikës dhe turpfit, personi i dënuar ose arrestuar sipas bazës së paraburgimit/ dënimit, kompensohet në shumën prej gjashtë (6) euro në ditë.

12.2 Për dëmin jomaterial/moral në emër të dhimbjeve të përjetuara psikike/shpirtërore, frikës dhe turpfit, personi i dënuar ose arrestuar sipas bazës së arrestit shtëpiak, kompensohet në shumën prej gjashtë (6) euro në ditë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

44. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
45. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

46. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individit mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]

47. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin Rev. nr. 138/21 të 14 prillit 2021 të Gjykatës Supreme, i njëjti ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, si dhe, e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.
48. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kushtet në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë edhe kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Konkretisht, rregulli 39 (2) parasheh:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij ”.

49. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin KI04/21, parashtrues *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26, shih gjithashtu rastin KI175/20, parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
50. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “*qartazi e pabazuar*” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “*pretendime qartazi të pabazuara*”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*” (shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “*qartazi të pabazuar*”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “*qartazi të pabazuara*”, rastin KI04/21, cituar më lart, paragrafi 27, si dhe rastin KI175/20, cituar më lart, paragrafi 38).
51. Në këtë kontekst, si dhe në tekstin në vijim, në mënyrë që të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht në rrethanat e rastit konkret, vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtoj thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KI04/21, cituar më lart, paragrafi 28).
52. Në dritën e të lartcekurave, Gjykata fillimisht rikujton se çështja thelbësore në rastin konkret është fakti që parashtruesi i kërkesës, gjatë periudhës kohore nga 25 marsi 2008 deri më 25 prill 2008 ka qenë në paraburgim, për dyshimin e kryerjes së veprës penale, dhe kundër tij ishte ngritur edhe aktakuzë. Procesi penal kishte vazhduar deri më 13 prill 2012 kur Gjykata Supreme i kishte konfirmuar aktgjykimet liruese të gjykatave të instancave më të ulëta. Parashtruesi thekson se gjatë kësaj periudhe ai ka përjetuar dhimbje shpirtërore në kohëzgjatje prej 4 (katër) vitesh. Parashtruesi i kërkesës kishte ndjekur procedurat kontestimore për kompensim dëmi në gjykatat e rregullta, ku si e paditur e parë ishte KGJK. Parashtruesi i kërkesës kërkoi, ndër të tjera, që në emër të dëmit jomaterial-për dhimbje shpirtërore për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, t’i paguhet shuma prej 800,000.00 euro. Gjykata Themelore fillimisht, i akordoi parashtruesit të kërkesës shumën prej 61,708.30€ për dëmin jomaterial, ndërsa Gjykata e Apelit,

zbriti kompensimin në shumën në 45,000 euro. Pas paraqitjes së revizionit, Gjykata Supreme përfundimisht vendosi që të kompensojë parashtruesin e kërkesës në vlerën prej 3,600.00 euro. Të tri instancat gjyqësore u bazuan në nenin 200 të LMD-së.

53. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pranë Gjykatës konteston lartësinë e kompensimit në rastin e tij, duke theksuar se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk ka arsyetuar mjaftueshëm, duke shkaktuar kështu shkeljen e të drejtës kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
54. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme shkel të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejt dhe të Paanshëm] sepse në esencë, ai pretendon se (i) Gjykata Supreme nuk ka arsyetuar vendimin e saj; dhe (ii) Gjykata Supreme ka qenë e ndikuar nga KGJK-ja sepse ky institucion mbikëqyr sistemin gjyqësor dhe bën emërimin e të gjitha niveleve të gjykatave të rregullta. Në vijim, Gjykata do të shqyrtojë veç e veç pretendimet e parashtruesit të kërkesës.

Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se (i) Gjykata Supreme nuk ka arsyetuar vendimin e saj

55. Sa i përket të së drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rosisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018; KI87/18, parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, dhe KI24/17, parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 27 majit 2019, KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).
56. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e

Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin KI87/18, parashtrues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 44).

57. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin *Moreira Ferreira kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 5 korrikut 2011 paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).
58. Gjykata sjell në vëmendje se thelbi i pretendimeve të parashtruesit ka të bëjë me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dhe vendim të arsyetuar. Në këtë linjë, Gjykata rikujton se fillimisht Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit C. nr. 3428/13, kishte akorduar për shkak të dëmit jomaterial-për dhimbje shpirtërore të shkaktuara për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit t'ia paguajnë shumën prej 61.708,30€, në esencë dhe duke llogaritur e akorduar në shuma përkatëse monetare ditët, duke u bazuar në (i) ekspertizën mjekësore për vuajtjet shpirtërore gjatë qëndrimit në paraburgim; (ii) kufizimin e aktivitetit sepse parashtruesi ka qenë i detyruar të paraqitet në stacion policor; (iii) për ngritjen e aktakuzës; (iv) për vuajtje shpirtërore përgjatë viteve 2009-2010; (v) për periudhën nga viti 2011 e deri në shpalljen e aktgjykimit lirues, më 7 korrik 2011; (vi) për periudhën nga shpallja e aktgjykimit lirues të gjykatës së shkallës së parë e deri më 3 prill 2012, ku parashtruesi është liruar nga përgjegjësia penale. Për vlerësimin e kompensimit, Gjykata Themelore ishte bazuar në nenin 200 të LMD-së, duke theksuar se shuma prej 61.708,30 euro është e drejtë dhe parashtruesi me këtë shumë mund t'i plotësojë të mirat e dëmtuara si pasojë e vuajtjeve dhe përjetimeve shpirtërore që ka përjetuar.
59. Gjykata e Apelit, në Aktgjykimin e saj Ac. nr. 5426/17 ka vendosur që në emër të kompensimit për dhimbje shpirtërore të shkaktuara për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, të paditurit t'ia paguajnë parashtruesit të kërkesës shumën prej 45.000 euro. Në këtë linjë, Gjykata e Apelit kishte arsyetuar:

“Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195, paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201, paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht për të paditurën e parë, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të bazuara pretendimet ankimore të të paditurës së parë për aplikimin e gabuar të drejtës materiale për shumën e gjykuar për paditësin. Gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka aplikuar dispozitën e nenit 200 të LMD-së, kur ka gjykuar në emër të dëmit jo material për dhimbjet e përjetuara shpirtërore si pasojë e privimit të kundërligjshëm nga liria dhe zhvillimit të procedurës penale ndaj tij, pasi që shumën e aprovuar për këtë bazë është e lartë dhe nuk i shkon për përshatit synimeve dhe qëllimeve shoqërore për kompensimin e dëmit, prandaj në këtë drejtim gjykata e shkallës së dytë e aprovoi pjesërisht ankesën e të paditurës së parë, e ndryshoi aktgjykimin e atakuar në pjesën e parë të tij (në pjesën që ka të bëjë me dëmin e gjykuar jomaterial) dhe gjykoi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se shumën e aprovuar nga gjykata e shkallës së parë në emër të dëmit jomaterial për dhimbjet e përjetuara shpirtërore si pasojë e cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit të paditësit, nuk bazohet në kriteret e zbatueshme për vlerësim, as në praktikën gjyqësore të krijuar nga gjykatat e Kosovës për këto forma të shpërblimit të dëmit dhe as në natyrën dhe llojin e të mirës së dëmtuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se shumën e gjykuar si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi është adekuate me kriteret dhe qëllimet e përcaktuara me nenin 200 të LMD lidhur me nenin 323 të LPK-së, se kjo shumë përfaqëson një satisfaksion adekuat që i dëmtuari (në këtë rast paditësi) t’i përballojë më lehtë dëmet jomateriale të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para. Me paragrafin 2 të nenit 200 të LMD-së përcaktohet se “me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të, të mos u shkojë përshatit synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”. Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e dhimbjeve shpirtërore të pësuar, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballimin e tejkalimit të pasojave të dëmit, që në këtë rast paditësi i ka pësuar si pasojë e privimit të kundërligjshëm të lirisë nga ana e institucioneve gjyqësore të Republikës së Kosovës, në të njëjtën kohë ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfaksion të vërtetë për atë që është e mundur, duke u shkuar për shatit synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Shumën e kërkuar përtej shumës së aprovuar si në pikën I të këtij aktgjykimi, për bazën e cekur si më lart, gjykata e shkallës së dytë refuzoi si të pabazuar, ngase gjeti se e njëjta nuk përkon me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë procedurë, e as me natyrën dhe shkallën e të mirës së

privuar të paditësit si pasojë e privimit të kundërligjshëm të lirisë së tij. Për këtë arsye duke u vendos sikurse në pikën I të këtij aktgjykimi.

Gjykata kur ka vendosur për vlerën e kompensimit ka marrë parasysh rrethanat që kanë ndikuar në atë shkallë të të drejtave të cenuara si pasojë e procedurës penale siç janë kohëzgjatja e qëndrimit në paraburgim, natyra e veprës për të cilën është akuzuar, moshën e të dëmtuarit, profesionin e tij dhe rrethanat familjare e shoqërore.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e vlerësuar si të drejtë dhe të rregullt vendimin e gjykatës së shkallës së parë në pjesën e refuzuar të tij për shkak se pjesa e refuzuar e kërkesëpadisë për dëmin jomaterial është përfundimi i drejtë. Edhe Gjykata e Apelit ka vlerësuar se kërkesëpadia ishte shumë e lartë dhe në shpërputhje me natyrën e dëmeve që i ishin bërë paditësit, e gjithashtu në shpërputhje edhe me qëllimin e kompensimit për dëmin jomaterial.”

60. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se përderisa Gjykata e Apelit, kishte aplikuar po ashtu nenin 200 të LMD-së, e njëjta i kishte akorduar parashtruesit të kërkesës shumë prej 45,000 euro, duke arsyetuar se (i) shuma e aprovuar nga gjykata e shkallës së parë është e lartë dhe nuk i shkon përshtati synimeve dhe qëllimeve shoqërore për kompensimin e dëmit; (ii) se shuma e gjykuar prej 45,000 euro nga vetë kjo gjykatë, është adekuate me kriteret dhe qëllimet e përcaktuara me nenin 200 të LMD-së lidhur me nenin 323 të LPK-së, se kjo shumë përfaqëson një satisfaksion adekuat që parashtruesi i kërkesës t'i përballojë më lehtë dëmet jomateriale të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para; (iii) kur ka vendosur për vlerën e kompensimit ka marrë parasysh rrethanat që kanë ndikuar në atë shkallë të të drejtave të cenuara si pasojë e procedurës penale, siç janë: a) kohëzgjatja e qëndrimit në paraburgim, b) natyra e veprës për të cilën është akuzuar, c) mosha e të dëmtuarit, d) profesioni dhe e) rrethanat familjare e shoqërore.
61. Më tej, Gjykata vëren se Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj Rev. nr. 138/2021, të 14 prillit 2021, kishte vendosur që t'i akordojë parashtruesit të kërkesës kompensimin për dëmin jomaterial, për dhimbje shpirtërore të shkaktuara për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit dhe që KGJK t'ia paguaj shumë prej 3,600.00€. Gjykata Supreme arsyetoi si në vijim:

“Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimeve të atakuara sa i përket dëmit jomaterial që paditësit në emër të dhimbjeve shpirtërore të shkaktuara për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, Gjykata Supreme duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare dhe sipas pretendimeve në revizion për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimeve në kuptim të dispozitës së nenit 224, paragrafi 1, i LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar e drejta materiale.

Gjendja faktike për dëmin jomaterial për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, e për të cilat është vendosur si në pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, sepse gjykata e shkallës së parë me ekspertizë mjekësore të punuar nga eksperti i psikiatrisë, ka gjetur se paditësi si pasojë e arrestimit dhe qëndrimit në paraburgim dhe kohëzgjatjes së procesit në procedurën penale të zhvilluar ndaj tij, deri në shpalljen e aktgjykimit dhe deklarimit si të pafajshëm, ka pësuar dhimbje shpirtërore, e cila dhimbje gjatë periudhës së paraburgimit ka qenë e intensitetit posaçërisht të lartë për 30 ditë, duke filluar nga momenti i arrestimit mediatik duke ju ekspozuar opinionit publik, me lajme duke përshkruar në detaje prangosjen e cila situatë denigruese ka ndikuar në dëmtimin e rëndë të imazhit dhe integritetit të tij e duke marrë parasysh se i njëjti është figurë publike. Ky moment te i njëjti ka ndikuar negativisht duke humbur imazhin dhe respektin tek të gjithë njerëzit të cilët i ka njohur. Kjo situatë ka ndikuar edhe në familjen e tij tek fëmijët dhe bashkëshortja në raport me njerëzit të cilët i kanë njohur në shkollë, shokë e shoqe. Pas lirimit nga paraburgimi te i njëjti kanë vazhduar dhimbjet shpirtërore, duke përjetuar ankthe, pagjumësi, gjendje reaktive emocionale si pasojë e dëmtimit të ekuilibrit dhe dinamikës psikike. Pastaj, i njëjti ka qenë nën stresin e vazhdueshëm për shkak të ecurisë së procesit gjyqësor kundër tij, duke qenë i pasigurt për të ardhmen e tij, për fëmijët e tij, periudhë kur është ndier i stigmatizuar nga shoqëria të cilët i kanë ikur dhe ju kanë shmangur kur është takuar me ta, duke vlerësuar këtë përfundim të gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata Supreme vlerëson se shumica e gjykuar nuk ishte në përputhje me qëllimin të cilit nuk i shërben kompensimit, andaj edhe u vendos që për këtë kërkesë të ndryshohen aktgjykimet.

Në rastin konkret në kontekstin e dispozitës nga paragrafi 1, i nenit 200 të LMD-së, paditësit i takon kompensimi për dhimbje shpirtërore për shkak të shkeljes së nderit ose të lirisë, dhe formulimi si në kërkesëpadi nga pala paditëse për këtë formë të dëmit në vete paraqet kërkesën për të dy këto kategori të cilat i ka njohur ligji si bazë për shpërblim të dëmit jomaterial, ndonëse janë paraqitur si një kërkesë e vetme monetare, andaj kjo gjykatë ka pasur parasysh këtë rrethanë me rastin e caktimit të lartësisë së dëmit jomaterial, duke vlerësuar se paditësit i është cenuar e drejta e lirisë, dhe po ashtu për shkak të zhvillimit të procedurës penale e cila ka përfunduar me aktgjykim lirues, të cilit i është cenuar edhe nderi, në kuptim të kësaj dispozite. Ndërsa formulimi si në kërkesëpadi “të dhimbjeve shpirtërore të shkaktuara për shkak të cenimit të autoritetit, dhe të drejtave të personalitetit, “ligji nuk i njeh si kategori të veçanta të shpërblimit të dëmit, por të njëjtat hynë në kuadër të dy kategorive të lartcekura për të cilat ligji njeh të drejtën e shpërblimit të dëmit jomaterial për dhimbje shpirtërore për shkak të shkeljes së nderit ose të lirisë, ndërsa duke marrë parasysh se nuk ka pasur kërkesë të veçantë monetare për këto kërkesa, gjykata i ka vlerësuar si jo ekzistente si të pavarura dhe të njëjtat i ka vlerësuar se hynë në kuadër të dy kërkesave për të cilat paditësit i është njohur e drejta për shpërblimin e dëmit jomaterial për dhimbje shpirtërore për shkak të shkeljes së nderit ose lirisë.

Po të kishte kërkesë dhe mund të gjykonte ndaras kërkesën për cenim të shkeljes së nderit dhe po ashtu ndaras kërkesën për cenim të lirisë, por kurrsesi nuk mund të qëndrojë si e veçantë kërkesa për dhimbje shpirtërore pa u ndërlidhë me ndonjërin nga rrethanat që e shkakton dhimbjen shpirtërore e cila gjithashtu duhet të jetë e përcaktuar apo përmbajtje e dispozitës ligjore e cila e parasheh mbrojtjen e të drejtës subjektive.

Me këtë rast Gjykata Supreme, vlerëson se për çdo kërkesë lidhur me dëmin jomaterial gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi t'i shkoj përshtati synimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksioni për të dëmtuarin.

Mbi këtë bazë duke e pasur parasysh natyrën e përjetimeve, të dhimbjeve në aspektin psikik të shkaktuara paditësit, gjykata vlerësojë posaçërisht rrethanat se natyra e veprës penale për të cilën ishte akuzuar paditësi ishte e rëndë shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit, dhe rrjedhimisht dhimbjet shpirtërore për shkak të akuzës kanë qenë të mëdha, ashtu siç edhe eksperti ka konstatuar me ekspertizë, po ashtu duke marrë parasysh kohëzgjatjen e qëndrimit në paraburgim për 30 ditë, pozitën të cilën e ka pasur në shoqëri para arrestimit, jehonën mediatike që ka pasur arrestimi i tij, si dhe praktikën e mirë gjyqësore të krijuar për këtë formë të dëmit jo material, vendosi që kompensimi të jetë në lartësi prej 3.600,00 euro, duke vlerësuar se me këtë shumë paditësi do të ketë një satisfaksion për përjetimet e marra si rezultat i privimit të lirisë dhe procedurave të zhvilluara.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë për këtë formë të dëmit jomaterial për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, Gjykata Supreme vlerëson se shuma e gjykuar nuk është në harmoni me pasojat e krijuara dhe me qëllimin të cilit i shërben kompensimi.

62. Më tej, duke iu referuar praktikës së GJEDNJ-së, Gjykata Supreme theksoi:

“Gjykata Supreme me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit të dëmit jomaterial për shkak të cenimit të nderit dhe lirisë, duke vendosur të aprovohet dhe refuzohet kërkesa si në dispoziv të këtij aktgjykimi, ka pasur parasysh edhe praktikën e krijuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, me seli në Strasburg, e cila në praktikën e saj të vendosjes lidhur me shkeljet nga neni 5 i Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (Gjykata Supreme i referohet rasteve: Shiksaitov kundër Sllovakisë; Affaire E.K kundër Greqisë; Teymurazyan kundër Armenisë), që kanë të bëjnë shkeljet e dispozitave të këtij neni ka caktuar shuma të përafërta me ato të gjykuara si në dispoziv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, me seli në Strasburg, me rastin e vendosjes lidhur me këto raste lidhur me nenin 5 të Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, ka pasur parasysh shkeljen e të drejtave të përcaktuara me këtë nen, që është e drejta për liri dhe siguri, volumin e të drejtave të cenuara dhe dhimbjeve shpirtërore të cilat janë shkakuar si pasojë e këtyre shkeljeve subjekteve të caktuara, dhe se shumatat e gjykuara

në këto raste nuk janë shuma të mëdha, pasi qëllimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka qenë satisfaksioni i të dëmtuarve me rastin e gjyqimit të shumave për dëmin jomaterial, dhe në asnjë mënyrë pasurimi i tyre.

Andaj, duke marrë parasysh praktikën e kësaj gjykate, dhe faktin se kërkesa e paditësit paraqet bazë për kompensim në bazë të nenit 5.5, të Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, se kemi të bëjmë me vendim lirues, me të cilin tani paditësi është liruar nga përgjegjësia penale për veprën penale shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit për të cilën ishte akuzuar, me çka drejtësia është vënë në vend dhe se paditësi asnjëherë nuk është shpallur fajtorë për veprën për të cilën është akuzuar, por edhe duke e marrë parasysh faktin se paditësi ka qëndruar në paraburgim 30 ditë, kohë kur paditësit i është cenuar e drejta e lirisë në kundërshtim me nenin 5 të Konventës, dhe ndaj tij procedura penale ka zgjatur nga 25.03.2008, kur është arrestuar, dhe deri me përfundimin e kësaj procedure me aktgjykim të formës së prerë më datë 03.04.2012, pasi që është një periudhë relativisht e gjatë, gjatë së cilës periudhë ka qenë i cenuar nderi i paditësit, dhe për këto arsye është e natyrshme që ka përjetuar dhimbje shpirtërore, të cilat fakte janë marrë parasysh me rastin e gjyqimit të shumës prej 3600.00 euro, që është shumë më e lartë se shumat e gjykuara edhe sipas praktikës së krijuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Duke marrë parasysh arsyet e lartcekura, çdo pretendim i palës paditëse sa i përket lartësisë së kompensimit të dëmit është i pathemeltë.”

63. Gjykata vëren se Gjykata Supreme për përcaktimin e lartësisë së shumës lidhur me kompensimin për shkak të dhimbjeve shpirtërore konsideroi se shuma e përcaktuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, nuk ishte në përputhje me qëllimin që i shërben kompensimit, andaj vendosi që shuma prej 3.600 euro ishte një satisfaksion për përjetimet e marra si rezultat i privimit të lirisë dhe procedurave të zhvilluara. Gjykata Supreme më konkretisht vendosi që kompensimi të jetë në lartësi prej 3.600,00 euro, duke vlerësuar se me këtë shumë parashtruesi i kërkesës do të ketë një satisfaksion për përjetimet e marra si rezultat i privimit të lirisë dhe procedurave të zhvilluara dhe këtë shumë e bazoi në: (i) natyrën e përjetimeve, dhe (ii) të dhimbjeve në aspektin psikik të shkaktuara parashtruesit të kërkesës, dhe (iii) duke vlerësuar posaçërisht rrethanat se natyra e veprës penale për të cilën ishte akuzuar parashtruesi i kërkesës ishte e rëndë sepse ishte vepra shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit, dhe që rrjedhimisht, sipas Gjykatës Supreme, dhimbjet shpirtërore për shkak të akuzës kanë qenë të mëdha, ashtu siç edhe eksperti ka konstatuar me ekspertizë; (iv) duke marrë parasysh kohëzgjatjen e qëndrimit në paraburgim për 30 (tridhjetë) ditë; (v) pozitën të cilën e ka pasur në shoqëri para arrestimit, (vi) jehonën mediatike që ka pasur arrestimi i tij, si dhe (vii) praktikën gjyqësore të krijuar për këtë formë të dëmit jomaterial. Gjykata Supreme, duke iu referuar tri rasteve të GJEDNJ-së, konsideroi se shumat e përafërta janë gjykuar edhe në ato raste. Në këtë linjë, Gjykata Supreme kishte arsyetuar se GJEDNJ, me rastin e vendosjes lidhur me këto raste, përkatësisht

nenit 5 të KEDNJ-së, ka pasur parasysh shkeljen e të drejtave të përcaktuara me këtë nen, që është e drejta për liri dhe siguri, pastaj volumin e të drejtave të cenuara dhe dhimbjeve shpirtërore të cilat janë shkaktuar si pasojë e këtyre shkeljeve subjekteve të caktuara, dhe se shumata e gjykuara në këto raste nuk janë shuma të mëdha, sepse qëllimi sipas GJEDNJ-së, ka qenë satisfaksioni i të dëmtuarve me rastin e gjykimit të shumave për dëmin jomaterial, dhe në asnjë mënyrë pasurimi i tyre.

64. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Gjykata Supreme duke iu referuar faktit që së pari, kemi të bëjmë me vendim lirues, me të cilin parashtruesi i kërkesës është liruar nga përgjegjësia penale për veprën penale shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit për të cilën ishte akuzuar, me çka drejtësia është vënë në vend dhe se parashtruesi i kërkesës asnjëherë nuk është shpallur fajtorë për veprën për të cilën është akuzuar. Së dyti mori parasysh faktin se parashtruesi i kërkesës ka qëndruar në paraburgim 30 ditë, kohë kur paditësit i është cenuar e drejta e lirisë në kundërshtim me nenin 5 të KEDNJ-së. Së treti, Gjykata Supreme konsideroi që ndaj parashtruesit procedura penale ka zgjatur nga 25 marsi 2008, kur është arrestuar, dhe deri me përfundimin e kësaj procedure me aktgjykim të formës së prerë më 3 prill 2012, e cila pasi që është një periudhë relativisht e gjatë, gjatë së cilës periudhë ka qenë i cenuar nderi i paditësit, dhe për këto arsye është e natyrshme që ka përjetuar dhimbje shpirtërore, të cilat fakte janë marrë parasysh me rastin e gjykimit të shumës prej 3,600.00 euro.
65. Gjykata rikujton se në rastet kur një gjykatë e shkallës së tretë, si në rastin e parashtruesit të kërkesës Gjykata Supreme, e cila vërteton vendimet e marra nga gjykatat më të ulëta – obligimi i saj për të arsyetuar vendimmarrjen dallon nga rastet kur një gjykatë ndryshon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta. (shih, në mënyrë të ngjashme, rastet e Gjykatës KI194/18, parashtrues *Kadri Muriqi dhe Zenun Muriqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shkurtit 2020, paragrafi 106; dhe KI122/19, parashtrues *F. M.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 9 korrikut 2020, paragrafi 100). Në rastin konkret, Gjykata Supreme nuk ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Apelit e as atë të Gjykatës Themelore sa i përket zbatueshmërisë së dispozitave përkatëse, e që në rastin konkret rezulton të jetë neni 200 i LMD-së, por e njëjta i ka akorduar për dëmin jomaterial, përkatësisht dhimbjet shpirtërore, parashtruesit të kërkesës një shumë më të ulët sesa gjykatat e instancave më të ulëta.
66. Gjykata në këtë linjë do të shfrytëzojë praktikën e GJEDNJ-së, për të vlerësuar, se arsyetimi për kompensimin e gjykuar nga Gjykata Supreme, a ka qenë në pajtueshmëri me standardet e GJEDNJ-së. Kjo e fundit, përmes nenit 5 të KEDNJ-së, konkretisht paragrafit 5 të saj, që shqyrton aspektet e kompensimit të personave të cilët kanë qenë të ndaluar pa arsye.
67. GJEDNJ ka përcaktuar që në rastet kur ligji vendor përcakton të drejtën për kompensim për personat e liruar nga akuza e të cilët janë privuar nga liria, një e drejtë e tillë automatike nuk nënkupton domosdoshmërisht se ndalimi në fjalë duhet të konsiderohet si në kundërshtim me dispozitat e nenit 5. Megjithatë, paragrafi 5 i nenit 5 zbatohet nëse ndalimi/paraburgimi karakterizohet nga gjykatat kombëtare si "i paligjshëm" brenda kuptimi i ligjit të brendshëm (shih

mutatis mutandis rastin e GJEDNJ-së *Norik Poghosyan kundër Armenisë*, paragrafët 34-36).

68. Gjykata vëren se nënparagrafi 1.1 i paragrafit 1 i nenit 529 (Personat që kanë të drejtë në kompensim për heqje lirie pa bazë) i KPPPRK-së përcakton që e drejta në kompensim dëmi i takon gjithashtu personit i cili është mbajtur në paraburgim, e kundër tij nuk është filluar procedurë penale ose procedura është pushuar me aktvendim të formës së prerë ose ai me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza apo akuza është refuzuar. Kjo është situata edhe me rrethanat e rastit konkret, ku parashtruesi i kërkesës është privuar nga liria në periudhë prej 1 (një) muaji, përkatësisht nga 25 marsi 2008 deri më 25 prill 2008, dhe procedura me Aktgjykim lirues të formës së prerë është nxjerrë nga Gjykata Supreme më 3 prill 2012.
69. Më tej, lidhur me paligjshmërinë e cenimit të lirisë së parashtruesit të kërkesës, në kontekst të aplikimit të tij për kompensimin, Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj kishte deklaruar se *“kjo gjykatë ka pasur parasysh këtë rrethanë me rastin e caktimit të lartësisë së dëmit jomaterial, duke vlerësuar se paditësit i është cenuar e drejta e lirisë, dhe po ashtu për shkak të zhvillimit të procedurës penale e cila ka përfunduar me aktgjykim lirues”*. Më tej, duke u mbështetur në praktikën e GJEDNJ-së, Gjykata Supreme kishte përcaktuar: *“duke marrë parasysh praktikën e kësaj gjykate, dhe faktin se kërkesa e paditësit paraqet bazë për kompensim në bazë të nenit 5.5, të Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, se kemi të bëjmë me vendim lirues, me të cilin tani paditësi është liruar nga përgjegjësia penale për veprën penale shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit për të cilën ishte akuzuar, me çka drejtësia është vënë në vend dhe se paditësi asnjëherë nuk është shpallur fajtorë për veprën për të cilën është akuzuar, por edhe duke e marrë parasysh faktin se paditësi ka qëndruar në paraburgim 30 ditë, kohë kur paditësit i është cenuar e drejta e lirisë në kundërshtim me nenin 5 të Konventës”*. Nga këto përfundime të Gjykatës Supreme, Gjykata konsideron se paragrafi 5 i nenit 5 është i aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret.
70. Në këtë linjë, Gjykata rikujton rastin *Teymurazyan kundër Armenisë*, të cituar nga vetë Gjykata Supreme, në të cilin është theksuar se paragrafi 5 i nenit 5 të KEDNJ-së, zbatohet kur është e mundur të aplikohet për kompensim në lidhje me heqjen e lirisë të bërë në kundërshtim me paragrafët 1, 2, 3, 4 të nenit 5 të KEDNJ-së. E drejta për kompensim të përcaktuar në paragrafin 5 presupozon që të jetë konstatuar një shkelje e njërës prej paragrafëve të tjerë, qoftë nga një autoritet vendas ose nga Gjykata. Për më tepër, paragrafi 5 i nenit 5 nuk duhet të interpretohet se ofron një të drejtë për kompensim të natyrës thjesht monetare, por gjithashtu duhet të ofrojë një të drejtë të tillë për çdo shqetësim, ankth dhe frustrimin që një person mund të pësojë si rezultat i shkeljes së dispozitave të tjera të nenit 5 të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së, *Teymurazyan kundër Armenisë*, Aktgjykim i 15 marsit 2018, paragrafi 76, dhe referencat e përdorura aty).
71. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës është kompensuar edhe për dëmin jomaterial si pasojë e dhimbjeve shpirtërore. Rrjedhimisht, çështja kryesore

dhe pretendimi kryesor mbetet shuma e kompensimit, për të cilën parashtruesi i kërkesës nuk është pajtuar.

72. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se GJEDNJ, përcakton se paragrafi 5 i neni 5 të KEDNJ-së nuk i jep të drejtë parashtruesit për një shumë të caktuar për kompensim (shih rastin e GJEDNJ-së, *Şahin Çağdaş kundër Turqisë*, Aktgjykim i 11 prillit 2006, paragrafi 34). Por, sigurisht që kompensimi i cili nuk është në proporcion me seriozitetin e shkeljes, i njëjti, nuk do jetë i përputhshëm me kërkesat e paragrafit 5 të nenit 5 të KEDNJ-së sepse kjo atëherë do bënte të drejtën garantuar nga kjo dispozitë teorike dhe iluzore (shih rastin e GJEDNJ-së, *Vasilevskiy dhe Bogdanov kundër Rusisë*, Aktgjykim i 10 korrikut 2018, paragrafi 22). Një shumë e dhënë nuk mund të jetë dukshëm më e ulët se ajo e dhënë nga GJEDNJ në raste të ngjashme (shih rastin e GJEDNJ-së, *Ganea kundër Moldavisë*, Aktgjykim i 17 majit 2011, paragrafi 30)
73. Për të vlerësuar më tej, se kompensimi i gjykuar nga Gjykata Supreme, a ka qenë në pajtueshmëri me standardet e GJEDNJ-së, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme iu ishte referuar tri rasteve të GJEDNJ-së, përkatësisht rasteve *Shiksaitov kundër Sllovakisë*; *Affaire E.K kundër Greqisë*; *Teymurazyan kundër Armenisë* me të cilat konsideroi se shumatat e përafërta janë gjykuar edhe në ato lëndë, përkatësisht raste. Gjykata Supreme kishte arsyetuar se GJEDNJ, me rastin e vendosjes lidhur me këto raste, përkatësisht nenit 5 të KEDNJ-së, ka pasur parasysh shkeljen e të drejtave të përcaktuara me këtë nen, që është e drejta për liri dhe siguri, pastaj volumin e të drejtave të cenuara dhe dhimbjeve shpirtërore të cilat janë shkaktuar si pasojë e këtyre shkeljeve subjekteve të caktuara, dhe se shumatat e gjykuara në këto raste nuk janë shuma të mëdha, sepse qëllimi sipas GJEDNJ-së, ka qenë satisfaksioni i të dëmtuarve me rastin e gjykimit të shumave për dëmin jo material, dhe në asnjë mënyrë pasurimi i tyre.
74. Si shembull, në rastin *Shiksaitov kundër Sllovakisë*, z. Shiksaitov ishte mbajtur në paraburgim në periudhë prej 1 viti, 9 muaj e 15 ditë. Në emër të dëmit jomaterial, GJEDNJ i kishte akorduar 8.500,00 euro (shih rastin e GJEDNJ-së *Shiksaitov kundër Sllovakisë*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020).
75. Gjykata, bazuar në parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën në një vendim të arsyetuar gjyqësor e të shtjelluara më lart, rikujton se në adresimin e pretendimeve të parashtruesve përkatës, gjykatat e rregullta, janë të detyruara që të japin përgjigje, ndër të tjera, lidhur me ato pretendime të cilat janë thelbësore ose përcaktuese për rrethanat e një rastit. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme ka adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, dhe asaj të Apelit përmes të cilave ishte caktuar lartësia e kompensimit të dëmit jomaterial për shkak të dhimbjeve shpirtërore. Gjykata Supreme i kishte sqaruar parashtruesit të kërkesës që kompensimi në lartësi prej 3.600,00 euro, është një satisfaksion për përjetimet e marra nga parashtruesi i kërkesës si rezultat i privimit të lirisë dhe procedurave të zhvilluara. Këtë shumë të kompensuar Gjykata Supreme e bazoi mes tjerash në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës, praktikën e GJEDNJ-së, praktikën gjyqësore të

Gjykatës Supreme, dhe duke vlerësuar që për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë për këtë formë të dëmit jomaterial për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, vlerëson se shumica e gjykuar nuk është në harmoni me pasojat e krijuara dhe me qëllimin të cilit i shërben kompensimi.

76. Në fund, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak se Gjykata Supreme nuk e ka arsyetuar vendimin e saj, janë (i) pretendime që kualifikohen si pretendime të “shkallës së katërt”; dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se (ii) Gjykata Supreme ka qenë e ndikuar nga KGJK-ja sepse ky institucion mbikëqyr sistemin gjyqësor dhe bën emërimin e të gjitha niveleve të gjykatave të rregullta

77. Gjykata gjithashtu rikujton se parashtruesi i kërkesës ka një pretendim lidhur me KGJK-në, duke theksuar se parashtruesi konsideron se shpërblimi i gjykuar për dëmin jomaterial për shkak të dhimbjeve shpirtërore për cenimin të autoritetit nderit, lirisë dhe të drejtat e personalitetit në shumën prej 3,600.00€ është rrjedhojë e gjykimit jo të drejtë, sepse sipas parashtruesit të kërkesës KGJK si palë e paditur e mbikëqyr sistemin gjyqësor dhe bën emërimin e të gjitha niveleve të gjykatave të rregullta, andaj “*dhe ky raport ekzistues ndërmjet gjykatave si dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, e ka vu palën paditëse në pozitë të pabarabartë dhe për rrjedhojë ka rezultuar gjykimi jo i drejtë nga të gjitha gjykatat instanciale*”.
78. Megjithatë, nga shkresat e lëndës Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e ngritë për herë të parë këtë pretendim pranë Gjykatës, dhe i njëjti për shkak të parimit të subsidiaritetit, për shkak mos shterimit substancial të këtij pretendimi nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata. (shih lidhur me mosshterimin substancial rastin KI107/21, parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 tetorit 2021 paragrafët 56-65). Gjykata ka parasysh që parashtruesi i kërkesës e ka ngritë këtë pretendim tek Institucioni i Avokatit të Popullit, megjithatë Gjykata të njëjtin nuk e merr parasysh sepse nuk është mjet efektiv i cili duhet të shterohet.
79. Në një kontekst të tillë, kur pretendimet e parashtruesit të kërkesës as formalisht por as në substancë/përmbajtje nuk janë ngritur pra gjykatave të rregullta, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së, sa i përket kriterit për shterjen e mjeteve juridike në kuptimin substancial, dhe rikujton se në rrethana të tilla, pretendimet e tilla nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata për mungesë të shterimit të mjeteve juridike në kuptim substancial. Bazuar në po të njëjtën praktikë gjyqësore, Gjykata kishte refuzuar shqyrtimin e pretendimeve përkatëse sepse të njëjtat nuk ishin ngritur asnjëherë para gjykatave të rregullta, ndër të tjera, edhe në rastet e Gjykatës: KI119/17, parashtrues: *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2019, paragrafi 71; KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues: *Basri Deva, Afërdita Deva*

dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS", Aktvendim për papranueshmëri, i 22 korrikut 2019, paragrafi 92; KI155/18, parashtrues: *Benson Buza*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shtatorit 2019, paragrafi 50; KI163/18, parashtrues: *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020, paragrafi 59, dhe KI239/19, parashtrues: *Hakif Veliu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2021, paragrafi 149).

80. Gjykata rithekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) shterimin në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e përdorimit të mjetit juridik, kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në "substancë" para gjykatave të rregullta në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, i kanë shfrytëzuar ato, në të dy kuptimet (shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI71/18, parashtrues: *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafi 57; rastin KI119/17, parashtrues: *Gentian Rexhepi*, cituar më lart, paragrafi 73; rastin KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues: *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, cituar më lart, paragrafi 94; rastin KI163/18, parashtrues: *Kujtim Lleshi*, cituar më lart, paragrafi 61; dhe rastin KI239/19, parashtrues: *Hakif Veliu*, cituar më lart, paragrafi 150).
81. Një qëndrim i tillë është në përputhshmëri të plotë me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, bazuar në të cilën, për aq sa ekziston një mjet juridik që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë, të paktën në substancë, argumentin për shkelje të një të drejte, atëherë ai mjet juridik duhet të shfrytëzohet. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, pranë gjykatave të rregullta kur ka mundur të ngrihet gjatë ushtrimit të një mjete juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi të cilën rregulli për shterimin e mjeteve juridike synon ta ofrojë (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së: *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KI119/17, cituar më lart, paragrafi 72; rastin KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues: *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, cituar më lart, paragrafi 93; rastin KI155/18, parashtrues: *Benson Buza*, cituar më lart, paragrafi 49; rastin KI163/18, parashtrues: *Kujtim Lleshi*, cituar më lart, paragrafi 60).
82. Marrë parasysh këto parime dhe në rrethana në të cilat, sipas shkresave të lëndës rezulton se këto pretendime specifike të parashtruesit të kërkesës janë ngritur për herë të parë para Gjykatës, ajo konkludon që parashtruesi i kërkesës nuk i ka dhënë mundësinë Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, që të adresojnë këto pretendime dhe me atë rast, të parandalojnë shkeljet e pretenduara që parashtruesi i kërkesës i ngrit drejtpërdrejtë pranë kësaj Gjykate, pa i shteruar mjetet juridike në kuptimin e tyre substancial (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI118/15, parashtrues: *Dragiša Stojković*, Aktvendim

për papranueshmëri, i 12 prillit 2016, paragrafët 30-39; rastin KI119/17, cituar më lart, paragrafi 74; rastin KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 95; dhe rastin KI163/18, cituar më lart, paragrafi 62).

83. Si rrjedhojë, Gjykata konkludon se ky pretendim duhet të refuzohet si i papranueshëm për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike, siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

84. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, duhet të deklarohen të papranueshme në tërësi, në pajtim me paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39, si dhe me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20, 47 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 dhe me paragrafin (2) të rregullit 39 dhe 59 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 2 shkurt 2022, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Radomir Laban




Gresa Caka-Nimani